



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V-të
Sesioni pranveror

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 29/2015

Prishtinë, më 03.08.2015, në orën 23:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani - kryetar, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka - anëtarë.

Munguan: Ilir Deda, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Nuk ka.

Stafi Mbështetës i Mbledhjes së Komisionit: Muhamet Bytyçi, Shaip Goxhuli dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozimvendimit të Qeverisë për emërimin e Kryetarit dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i propozimvendimit të Qeverisë për emërimin e Kryetarit dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

Kryetari Naser Osmani njoftoi anëtarët e Komisionit se në këtë mbledhje të Komisionit do të shqyrtohet propozimvendimi nr.02/41 i datës 31.07.2015 i Qeverisë së Republikës së Kosovës

për emërimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Shyrtimi i këtij propozimvendimi të Qeverisë bëhet duke pasqyruar urgjencën për emërimin e këtij Komisioni. Në vazhdim z.Osmani potencoi se Qeveria për Kryetar dhe anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ka propozuar, si në vijim: **z.Safet Hoxha, Kryetar; z.Sami Uka, anëtarë; dhe z.Ergin Kala, anëtarë.**

Komisioni me shtatë (7) vota “për”, një (1) “kundër” dhe asnjë “abstenim” nxorri këtë:

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit të emërojë kandidatët e propozuar nga Qeveria për kryetarë dhe anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, si në vijim:

- 1.1. z.Safet Hoxha, Kryetar;*
- 1.2. z.Sami Uka, anëtarë; dhe*
- 1.3. z.Ergin Kala, anëtarë.*

2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputeti Naser Osmani, kryetar i Komisionit.

3. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 23:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Naser Osmani